

L I G J
Nr.7985, datë 13.9.1995

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7696, DATË 7.4.1993 “PËR
SHËRBIMIN E ROJAVE CIVILE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 3 të ligjit nr.7696, datë 7.4.1993, fjala “Firma private” zëvendësohet me fjalën “shoqëri të rojave civile” dhe shtohet paragrafi:

“Shoqëritë e rojave civile e zhvillojnë veprimtarinë e tyre jashtë ndikimeve të partive politike e organizatave shoqërore. Atyre u ndalohe të organizohen në shoqata të ndryshme të çdo lloji”.

Neni 2

Në dispozitat e neneve 3, 4, 6, 8, 9 e 14 të ligjit nr.7696, datë 7.4.1993, fjalët “organet e rendit Publik”, “Ministria e Rendit Publik” dhe “Ministri i Rendit Publik” zëvendësohen me fjalët, përkatësisht, “organet e Brendshme”, Ministria e Brendshme” dhe “Ministri i Brendshëm”.

Neni 3

Në nenin 4 të ligjit nr.7696, datë 7.4.1993, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Numri i efektivit të rojave që punëson një shoqëri e rojave civile përcaktohet në marrëveshje me organet e Brendshme. Numri i armëve që do të ketë një shoqëri në pronësi ose në përdorim të jetë deri në 2 për qind e efektivit të organit të Brendshëm të njësisë administrative ku vepron”.

Neni 4

Në nenin 5 të ligjit nr.7696, datë 7.4.1993, kërkesa “Të kenë mbaruar arsimin e detyruar” ndryshohet si vijon:

“Të kenë mbaruar arsimin e mesëm dhe të jenë nën moshën 55 vjeç.”

Po në këtë nen të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Drejtuesit e shoqërive të rojave civile të kenë mbaruar arsimin e mesëm”.

Neni 5

Në nenin 6 të ligjit nr.7696, datë 7.4.1993, shtohet paragrafi:

“Në objekte të veçanta, në marrëveshje me drejtuesin e objektit dhe me organet e Brendshme, rojat civile mund të qëndrojnë pa armatim dhe uniformë, por në këto raste ata duhet të kenë në anën e majtë të kraharorit mbishkrimin “roja civile private”. Çdo shoqëri e rojave civile ka stemën e cila është e njëjtë për të gjitha shoqëritë dhe një shenjë të veçantë për çdo shoqëri.

Neni 6

Neni 9 i ligjit nr.7696, datë 7.4.1993, ndryshohet si vijon:

“Kur vërehet që drejtuesi i shoqërisë i rojave civile humbet një ose disa nga kushtet e përcaktuara në nenin 5 ose abuzon me lejen e ushtrimit të profesionit, organet e Brendshme urdhërojnë

pezullimin nga shërbimi deri në marrjen e vendimit nga komisioni që e ka pajisur me këtë leje. Ky pezullim nga shërbimi mbetet në fuqi deri në marrjen e vendimit nga komisioni përkatës kompetent.”

Neni 7

Neni 12 i ligjit nr.7696, datë 7.4.1993, ndryshohet si vijon:

“Drejtuesve të shoqërive të rojave civile u ndalohet të punojnë roja civile pa i pajisur më parë ato me leje të ushtrimit të profesionit.

Rojë civile jashtë shoqërive të rojave civile mund të punësohen në bazë të aktmarrëveshjes të Ministrisë të Brendshme me ministrinë dhe institucionet e tjera shtetërore.”

Neni 8

Neni 13 i ligjit nr.7696, datë 7.4.1993, ndryshohet si vijon:

“Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 3, 4, 5 dhe 12 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 50 000 lekë. Gjoha jepet me vendim të shefit të komisariatit të policisë”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekreten nr.1228, datë 26.9.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha